



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL.Anr.868/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Behxhet Reçica, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr.2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Pranohet** pjesërisht si i bazuar apeli i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Behxhet Reçica nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.868 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Prishtinë, në Vendvotimet: 1931e/01R, 1931e/02R, 1931e/02D, 1927e/01R,

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

**IV. Refuzohet** si i pabazuar apeli në raport me vendvotimet:1912e, 1919e,1904/e

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 10.11.2017, e Behxhet Reçica, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, dega në Prishtinë, i cili sipas rezultatit përfundimtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka vetëm 66 vota dhe pretendon se ka më shumë vota me të cilën i mungojnë edhe votat e familjarëve të tij në këto vendvotime: 1931e/01R,1931e/02D,1931e/02D, në shkollën Anton Zako Çajupi me të cilën pretendon se i mungojnë përafërsisht 20 vota, në qendrën e votimit

1912 e në sallën 1 tetor i mungojnë së paku 15 vota, në vendvotimin 1927e/01R në shkollën “Shkëndia” i mungojnë minimum 15 vota, në QV 1919e në shkollën “Ahmet Gashi” 30 vota dhe në QV 1904e në shkollën fillore “Dardani” 36 vota. Kërkon nga paneli që të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në të gjitha këto QV dhe VV.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **Apeli është i bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën në vendvotimet e cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, paneli konstatoi se Vendvotimet:1912e,1919e,1904/e sepse nuk janë specifikuar vendvotimet sakt në Qendrat e Votimit ku pretendohet se ka pasur parregullsi

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura PZAP-i vendosi si në pjesën II të dispozitivit të vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.868/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyhdi Haxiri**



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.